



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 157, Datë 09.07.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “BLAC ENERGY” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC “BLAC” ME FUQI TË INSTALUAR
1300 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 09.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Blac Energy“ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Blac Energy” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me Nr. 379 Prot., datë 10.05.2018.ka paraqitur kërkesë për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 119, datë 04.06.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”, me fuqi të instaluar 1300 kW.
- Në vijim të këtij vendimi, me shkresën nr. 55/33 Prot, datë 08.06.2018 u botua në median e shkruar njoftimi për fillimin e kësaj procedure.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10 pika 10 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në

Sektorin e Energjisë Elektrike”, në lidhje me paraqitjen e objeksioneve dhe ankesave nga të tretët, nuk rezulton të jenë paraqitur të tilla në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Blac Energy” sh.p.k, është një subjekt tregtar i krijuar me qëllim kryerjen e veprimtarisë me objekt financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirmbajten e HEC “Blac” dhe transferimin e HEC-it tek Autoriteti Kontraktues në përfundim të afatit të kontratës së konçensionit të formës BOT, me Nr. 578 Rep. dhe Nr. 269 Kol., datë 14.10.2015, të lidhur ndërmjet saj (shoqërisë) në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë si dhe Kontratës Shtesë të Koncesionit, me Nr. 241 Rep. dhe Nr. 87 Kol., datë 05.04.2016, të lidhur ndërmjet të njëjtave palë.
- Fuqia e instaluar e HEC “Blac”, do të jetë 1,300 kW.
- Aplikimi i shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”* si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Blac Energy“ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac” me fuqi të instaluar 1300 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.